



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1083 Prot.

Tiranë, më 18.09.2025

UDHËZIM

Nr. 40<sub>01</sub>, datë 18.09.2025

PËR NDRYSHIM E URDRIT NR. 40, DATË 01.08.2025 "PËR  
INTEGRIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE TË DEDIKUARA PËR FËMIJË NË  
DOKUMENTET E PLANEVE TË DETAJUARA VENDORE (PDV)"

Në zbatim të ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" e ndryshuar, VKM Nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", si dhe në funksion të garantimit të së drejtës së fëmijëve për një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin dhe mirëqënie,

UDHËZOJ:

1. Pika 2 e Udhëzimit Nr.40 datë 01.08.2025 ndryshohet si më poshtë:  
*"2. Sipërfaqja minimale e dedikuar për këtë funksion duhet të jetë jo më pak se 30 m<sup>2</sup> për çdo 1,000 m<sup>2</sup> ndërtim total mbi tokë, referuar planit të detajuar vendor të miratuar për njësinë strukturore."*
2. Tek pika 3 e Udhëzimit Nr.40 datë 01.08.2025 ndryshohet nënpika i, e germës a) si më poshtë:  
*"i. Të ruhet sipërfaqja minimale e përcaktuar për funksionin, e cila duhet të jetë jo më pak se 300 m<sup>2</sup>. Hapësira publike e dedikuara për fëmijë mund të projektohet me forma të lira, për të krijuar hapësira më natyrore dhe atraktive, por këndi i lojërave duhet të ketë një gjerësi minimale prej 12 m për të garantuar funksionalitet."*
3. Ngarkohen Autoritetet Vendore, të cilat ndërmarrin nismën për hartimin e dokumentave të Planit të Detajuar Vendor si dhe AKPT, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi.
4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe i komunikohet të gjitha njësive të qeverisjes vendore.

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Adelina Greca